

LIGJ
Nr. 82/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në paragrafin 3, të pikës 2, pas fjalëve “të Këshillit të Ministrave” shtohen fjalët “në zbatim të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të këtij ligji”.

2. Në pikën 3, shkronja “a”, togfjalëshi “si dhe të ndërtimeve për qëllime publike” shfuqizohet.

3. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike.

Përfshirja e parashikuar në këtë nen nuk konsiderohet ulje apo heqje e taksës së të ardhurave vendore, në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 69/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 19, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.